



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Panelli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavave

Anr.179/2019

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rrustem Thaqi kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Zyndi Haziri anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Antigona Murati, duke vodosur përkitazi me ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje, me seli në Prishtinë Dega në Pejë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë-Dega në Pejë, për shkak të vodosjes së shtandës në hapsirë publike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datë 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me datë 04.10.2019, mori këtë:

### V E N D I M

**Pranohet** ankesa Anr.179/2019 e datës 02.10.2019, e paraqitur nga Lëvizjes Vetëvendosjes (LVV), me seli në Prishtinë-Dega në Pejë, ndërsa subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike - vodosjes së Shtandit në rrugën Qendra e Qytetit të Pejës, tek Ura “Mihlet Bashqe” i Shqiptoher gjobë në lartësi prej 3,300.00 euro (tre mijë e treqind), dhe DETYROHET ta paguaj në afat prej 15 ditësh, nga data e pranimit të këtij vendimi, nën kërcënim të përmbarimit.

### A r s y e t i m

Me datën 02.10.2019, Lëvizja Vetëvendosje ka paraqitur ankesë në PZAP, në të cilën pretendon se me datë 02 tetor 2019 në orën 15:16, në Qendrën e qytetit në Pejë, tek Ura “Mihlet Bashqe”, kanë vërejtur se Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), ka vodosur një Shtand të kandidatit të tyre Brahim Selimaj, në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së dhe rregullën zgjedhore 13/2013 të KQZ-së. Me propozim për panelin që të pranohet ankesa si e bazuar. Në cilësi të provës ankesës ia ka bashkangjitur disa fotografi

Në përgjigje në ankesë të datës 04.10.2019, subjekti politik LDK, konsideron se ankesa e subjektit politik LVV, ka bazë ani pse në kushtet dhe rrethanat në të cilat është duke u zhvilluar fushata zgjedhore, duke pasur parasysh faktin se Komunat, nuk kanë arritur që të krijojn hapsira të veqanta, për vodosjën e materialeve zgjedhore siç kërkohet me dispozitat ligjore, vodosja e shtandit përkohësisht nga kandidati i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Brahim Selimaj në rrugën qendra e qytetit të Pejës, tek Ura “Mihlet Bashqe” nuk përbën një shkelje të rënd. Pavarsishtë kësaj Lidhja Demokratike e Kosovës e pranoi si formë të shkeljes së supozuar dhe se kemi ndërmarr masat e duhura për ta larguar shtandit e vodosur nga kandidati në fjalë dhe kemi respektuar urdhrin e PZAP-it, për ta larguar shtandën menjëherë.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

### Ankesa është e bazuar

Paneli nga fotot e ofruara si provë nga parashtruesi i ankesës, të cilat gjendet në shkresat e lëndës, në mënyrë të padishimtë, ka konstatuar se shtandi me materialet zgjedhore të subjektit politik LDK, është vodosura në hapësirat publike në rrugën qendra e qytetit të Pejës tek Ura “Mihlet Bashqe”.

Nga dëshmitë e sipërcituara Paneli, në mënyrë të sigurt ka vërtetuar se nga subjekti politik LDK, me seli në Prishtinë - Dega Pejë, janë bërë shkeljet e Kodit të Mirësjelljes për Subjekte Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, nga fakti se shtandi është vendosur në hapësirat publike, paraqesin veprime të sanksionuara me nenin 33 pika b) e LZP-së, e cila përcakton “*Vendosja e njoftimeve, plakateve dhe postereve, ose përndryshe, vendosja e emrave të tyre ose e sloganave në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave, në apo mbi rrugë publike, në shenjat publike të trafikut, brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose, ndryshe, që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare, ose brenda ose në hapësirat private pa lejen e pronarëve ose shfrytëzuesve*”.

Paneli, vendimin e tij e ka mbështet në dëshmi të qarta dhe bindëse siç përcaktohet me nenin 117 par. 3 të LZP-së, prandaj pretendimet në përgjigje në ankesë nuk u cilësuan me ndikim në meritat e lëndës.

Parashtrimet në përgjigje në ankesë, se veprimet e subjektit politik LDK, nuk mund të konsiderohen si shkelje pasi që komuna nuk ju ka mundësuar te kenë hapësira te veqanta për vendosjen e materialeve zgjedhore. Paneli pretendimet e tilla i vlerësoj si të pa bazuara dhe si të tilla i refuzoj pasi që, me këto pretendime nuk justifikon veprimet që janë të ndaluara dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore të nenit 33 pika b) i LZP-së, si dhe nen 5 paragrafi 1 pika d) e Rregullës 13/2013, ku parashihet se subjektet e certifikuara politike aktivitetet e tyre zgjedhore duhet t'i bëjnë në pajtueshmëri me Rregullat Zgjedhore të Komisionit Qendoror Zgjedhor (KQZ). Ky përfundim ka të bëjë me faktin se Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtaret e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë periudhës së fushatës, veprimet e subjekteve politik të jenë në një atmosferë të tolerancës demokracisë, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrëthanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor, shkallën dhe peshën e shkeljes, pjesëmarrjen e subjekti politik në zgjedhjet e mëparshme që konsiston në faktin se LDK-ja, ka qenë e njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, shkeljet e ligjeve zgjedhore në fuqi që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje dhe në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë, që do të thotë se i njëjti është i njoftuar me rregullat zgjedhore si dhe shumën e fondeve që ka marr subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve lidhur më fushatën zgjedhore.

Ndërmarrja e masave përmirësuese ka ndikuar në lartësinë e gjobës sepse nga fotografitë e dërguara si dëshmi në përgjigje në ankesë shifet se subjekti politik LDK, ka bërë përmirësimin e shkeljes, Paneli po ashtu vlerësoi se dënim i shqiptuar ndaj subjektit në fjalë do të ndikoj që mos të përsëriten veprimet e kësaj natyre në të ardhmen

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
Anr.179/2019 më datën 02.10.2019

Kryesues e Panelit  
Rustem Thaqi



**Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së.